



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I INSTITUCIONIT

**VENDIM**

**Nr. \_\_, Datë \_\_.02.2012**

**Objekti:** Miratimin e listave të kandidatëve për autoritet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve.

**Baza Ligjore:** Bazuar në Nenin 21, pika 3 e Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikës pikës 5.5 dhe pikës 5.6 të Vendimit Nr. 1, datë 17.01.2012 të Senatit Akademik të UART, për miratimin e rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve", i ndryshuar

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Institucionit, pasi u mblodh dhe shqyrtoi çështjen e parashikuara në rendin e ditës

**VËREN SE:**

Më datë 26 janar 2012, Senati Akademik i Universitetit të Arteve ka marrë vendim për ngritjen e KOZI-s, së Universitetit dhe me datë 27 është bërë konstituimi i tij. Sipas pikës 6.1 të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve", i ndryshuar, afati për paraqitjen e kandidatëve është 5 ditë kalendarike nga konstituimi. Afati i fundit për pritjen e kandidaturave për organe dhe autoritete drejtuese ishte data 31 janar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidimit nga ana e KOZI-së, u renditen dhe miratuan listat e kandidaëve për organe dhe autoritete drejtuese në Universitetin e Arteve. Për sa më sipër KOZI:

**VENDOSI**

1. Të miratojë kandidaturat për autoritetet drejtuese në Universitetin e Arteve si mëposhtë:
  - a. Listës Nr. 1 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Rektorit në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,

- b. Listës Nr. 2 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Dekanit në Fakultetin e Muzikës, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,
- c. Listës Nr. 3 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Dekanit në Fakultetin e Artit Skenik, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,
- d. Listës Nr. 4 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Dekanit në Fakultetin e Arteve të Bukura, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,
- e. Listës Nr. 5 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Përgjegjësit të Departamentit KMD, në Fakultetin e Muzikës, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,
- f. Listës Nr. 6 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Përgjegjësit të Departamentit të Interpretimit, në Fakultetin e Muzikës, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,
- g. Listës Nr. 7 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Përgjegjësit të Departamentit të Aktrimit dhe Regjisë së Filmit e Televizionit, në Fakultetin e Artit Skenik, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur,
- h. Listës Nr. 8 "Për shpalljen e Kandidaturave për postin e Përgjegjësit të Departamentit të Regjis, Skenografis, Koreografis dhe Teorinë e Arteve, në Fakultetin e Artit Skenik, në Universitetin e Arteve" sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Të miratojë kandidaturat për organet drejtuese në Universitetin e Arteve si mëposhtë:

- i. Listës Nr. 9 "Për shpalljen e Kandidaturave për anëtar në Senatin e Universitetit të Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur,
- j. Listës Nr. 10 "Për shpalljen e Kandidaturave për anëtar në Këshillin e Administrimit të Universitetit të Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur,
- k. Listës Nr. 11 "Për shpalljen e Kandidaturave për anëtar në Këshillin e Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur,
- l. Listës Nr. 12 "Për shpalljen e Kandidaturave për anëtar në Këshillin e Fakultetit të Artit Skenik, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur,

m. Listës Nr. 13 "Për shpalljen e Kandidaturave për anëtar në Këshillin e Fakultetit e Arteve të Bukura, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur,

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arben	LLOZI	<b>Kryetar</b>
Biselda	SHEHU	<b>Zëvendëskryetar</b>
Edmond	GJIKOPULLI	<b>Anëtar</b>
Gentjan	TABAKU	<b>Anëtar</b>
Erald	BAKALLI	<b>Anëtar</b>